



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1, 10¹ dhe 13 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), dhe në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) nga Ligji për procedurë të përgjithëshme administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.124/15), në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-111 të datës 7.3.2023 dhe Propozimin PA1 nr.08-111 datë 17.3.2023, dhe në pajtim me Konkluzionin, ark.nr.02-1188/16 datë 21.3.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 11-të mbajtur më 21.3.2023, miratoi:

AKTVENDIM
për ndalim të procedurës së inicuar për heqje
të lejes për transmetim në radio

NDALOHET procedura e inicuar për heqjen e ljes për transmetim në radio ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (SHTR) RADIO MEDISON SHPKNJP Kërçovë, nr.08-104 datë 5.1.2015.

A r s y e t i m

Këshilli i Agjencisë në seancën e 9-të mbajtur më 8.3.2023, me Konkluzionin, ark.nr.02-1007/19 datë 8.3.2023, miratoi propozimin e drejtorit të Agjencisë, dr.Zoran Trajčevski, PA1 nr.08-111 datë 7.3.2023 dhe inicioi procedurë për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR RADIO MADISON SHPKNJP Kërçovë, nr.08-104 datë 5.1.2015, për faktin se pas mbikëqyrjes së rregullt administrative, në Raportin me shkrim ark.nr.05-1018/1 datë 6.3.2023, është konstatuar se transmetuesi në afatin ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e prnimit të faturës së lëshuar nga Agjencia, nuk ka përmbushur detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, përkatësisht nuk ka paguar kompensimin (tarifën) vjetore për lejen për transmetim në radio Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Në lidhje me këtë, nga Agjencia më datë 9.3.2023 drejtuar transmetuesit të lartpërmendur i është dërguar Shkresë PA1 nr.08-111 datë 9.3.2023, për njoftim se nëse nuk paguan kompensimin (tarifën) vjetore për leje për transmetim në radio, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio.

Megjithatë, më 14.3.2023 drejtuar drejtorit të Agjencisë, nga Sektori i Financave dhe Logjistikës, është dorëzuar Njoftim ark.nr.05-1018/2 datë 14.3.2023 që SHTR RADIO MEDISON SHPKNJP Kërçovë, më 13.3.2023 ka kryer pagesë në shumë prej 15.852,00 (pesëmbëdhjetë mijë e tetëqind e pesëdhjetë e dy) denarë, me të cilën transmetuesi e ka pguar plotësisht tarifën vjetore për leje për transmetim në radio.

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1, 10 dhe 13 të Ligjit për Shërbime

Уп1 Бр.08-111

Скопје 22.03.2023 г.



Агенција за аудио и
аудиовизуелни
медиумски услуги

ул. Македонија бр.38
1000 Скопје
Република Северна
Македонија

Тел. + 389 2 3103 400

www.avmu.org.mk
www.avmu.mk
contact@avmu.mk





REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) nga Ligji për procedurë të përgjithëshme administrative, në lidhje me Propozimin PA1 08-111 datë 7.3.2023 dhe Propozimin PA1 nr.08-111 datë 17.3.2023, dhe sipas Konkluzionit ark.nr.02-1188/16 datë 21.03.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 11-të mbajtur më 21.3.2023, vendosi ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes.

Bazuar në sa më sipër u mor vendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele,
Kryetari i Këshillit
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

¹ Алинеите 8 и 9 се избришани, види: член 8 од Закон за изменување и дополнување на Законот за аудио и аудиовизуелни медиумски услуги („Службен весник на Република Македонија” бр.248/18).